



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.05.2025
Numër Protokolli: 3437/2025

A.nr.561/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi – Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 561/2025, të datës 27.03.2025, të parashtruar nga ankuesja A.T., kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “Vlerësim i Rezultateve të Punës”, në pajtim në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.05.2025, mori ketë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 561/2025, e datës 27.03.2025, e parashtruar nga ankuesja A.T, ashtu që Anulohet Formuari për Vlerësimin e Rezultateve në pune për ankuesen A.T, për vitin 2024, i datës 28.02.2025, i nxjerr nga Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.

II. Obligohet Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, dega Vushtrri, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, të beje vlerësimin e rezultateve në pune për ankuesen për vitin 2024 sikurse përcaktohet në piken II të diapozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja A.T.(me tej referuar vetëm ankuesja), më datë 24.03.2025 përmes postës së Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar me datën 27.03.2025, në Këshill e regjistruar nën shenjën A.nr. 2066/2025, kundër Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2024, me pretendimet ankimore se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2024, nga mbikëqyrësi në raport me mua është me mesataren 2.12, e që konsiderojë që përveç se nuk është i mbështetur në prova është vlerësim i cili bie në kundërshtim me provat dhe raportimet nga vet Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, dhe me raportin e Këshillit Gjyqësor të

Kosovës që në bazë të statistikave të Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtri, ka dal si gjykata me efikasë në nivel vendi e krejt kjo si rezultat i menaxhimit të mirë dhe efikas.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 02.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Sekretariati i Këshillat Gjyqësor të Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 28.04.2025 ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2066/2025 të datës 27.03.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raporti Vjetor i punës i datës 17.01.2025, dërguar nga A.K, për B.K; Raporti i barazimit të hyrave për periudhën nga data 01.01.2024, deri me datën 28.03.2024 i datës 25.04.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave për periudhën nga data 01.01.2024, deri me datën 7.06.2024 i datës 25.07.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave për periudhën nga data 01.01.2024, deri me datën 27.09.2024 i datës 25.10.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave për periudhën janar dhjetor i vitit 2024 i datës 03.02.2025, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 01.01.2024, deri me datën 30.01.2024; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 31.01.2024, deri me datën 28.02.2024, i datës 14.03.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 29.02.2024, deri me datën 28.03.2024, i datës 19.04.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 29.03.2024, deri me datën 29.04.2024; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 30.04.2024, deri me datën 30.05.2024, i datës 14.06.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 31.05.2024, deri me datën 27.06.2024, i datës 09.07.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 28.06.2024, deri me datën 30.07.2024, i datës 15.10.2024, i dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 31.07.2024, deri me datën 27.08.2024, i datës 18.09.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 28.08.2024, deri me datën 27.09.2024, i datës 15.10.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMH për periudhën nga data 30.09.2024, deri me datën 30.10.2024, i datës 18.11.2024, dërguar nga A.T; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMS për periudhën nga data 31.10.2024, deri me datën 27.11.2024, i datës 16.12.2024, i datës 16.12.2024; Raporti i barazimit të hyrave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtri i regjistruar ne SEMS për periudhën nga data 29.11.2024, deri me datën 31.12.2024, i datës 14.01.2025, dërguara nga A.T; Raporti i përgjithshëm për gjykatë lëmia penale, për periudhën nga data 01.01.2024, deri me datës 31.12.2024; Raporti i përgjithshëm për gjykatë lëmia civile, për periudhën nga data 01.01.2023, deri me datës 31.12.2023; Raporti i përgjithshëm për gjykatë lëmia civile, për periudhën nga data 01.01.2024, deri me datës 31.12.2024; emali i datës 21.02.2025, dërguar nga A.M, për A.T; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2024, për ankuesen A.T; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, për ankuesen A.T; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesen A.T; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2023, për ankuesen A.T; Zarfi i postes së Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 02.04.2025, dërguar nga R.K ,për F.K; Përgjigjen

në ankesë me numër protokolli 561/2025, e datës 28.04.2025; Akt Emërimi me numër protokolli 1418, i datës 01.07.2024; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën ‘Ndhmës Administrator’.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 1418 të datës 01.07.2014, është e punësuar në pozitën ‘Ndhmës Administratore’, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, në kategorinë drejtues i mesëm.

Me tej, Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatëse Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, me datën 28.02.2025 ankueses i ka bërë vlerësimin e rezultateve në pune për vitin 2024, duke e vlerësuar me notën e përgjithshme 2.12.

Ankuesja A.T, e pakënaqur me Vlerësimin e rezultateve në pune, të bërë Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatëse Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, me datën 27.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2024, nga mbikëqyrësi në raport me mua është me mesataren 2.12, e që konsiderojë që përveç se nuk është i mbështetur në prova është vlerësim i cili bie në kundërshtim me provat dhe raportimet nga vet Gjyqtari i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, dhe me raportin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës që në bazë të statistikave Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, ka dal si gjykata me efikase në nivel vendi e krejt kjo si rezultat i menaxhimit të mirë dhe efikas.

Nga shkresat e lëndës del se Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatëse Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri, me datën 28.02.2025 ankueses i ka bërë vlerësimin e rezultateve në pune për vitin 2024, duke e vlerësuar me notën e përgjithshme 2.12.

Kolegji i Këshillit lidhur me çështjen juridike sa i përket vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen, ju referuara dispozitave ligjore në fuqi, gjegjësisht nenit 9, paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores Nr. 10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë Për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku përcaktohet se; 2. *Periodha e vlerësimit zgjat një (1) vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri në ditën e fundit të muajit shkurt të vitit pasues për vitin paraprak.* 3. *Mbikëqyrësi, bënë vlerësimin, notimin e rezultateve në punë të nëpunësit sipas niveleve të vlerësimit të përcaktuara në paragrafin 13 të nenit 52 të LZP-së si dhe si dhe nenit 12 të kësaj rregullore, ndërlidhur me nenin 11, paragrafi 1,2,3 dhe 4 të Rregullores Nr. 10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë Për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ku përcaktohet se; 1. Vlerësimi për arritjen e objektivave të punës përbën gjashtëdhjetë për qind (60%) të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i sjelljeve profesionale të nëpunësit përbën dyzet për qind (40%) të rezultateve përfundimtare të vlerësimit.* 2. *Nota mesatare e objektivave kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë objektivave të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e objektivave të vlerësuar.* 3. *Nota mesatare e sjelljeve profesionale (aftësive) kalkulohet duke mbledhur notat e të gjithë aftësive të vlerësuar dhe duke pjesëtuar me numrin e aftësive të vlerësuar.* 4. *Nota e përgjithshme kalkulohet duke mbledhur gjashtëdhjetë për qind (60%)(shumëzuar me 60 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të objektivave dhe dyzet për qind (40%) (shumëzuar me 40 dhe pjesëtuar me 100) të notës mesatare të aftësive.*

Duke marr parasysh dispozitat e cekura si më lartë, dhe po ashtu duke marr parasysh provat materiale të lëndës, konkretisht Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025 për ankuesen

e cila është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.12. në nivelin “Ka nevojë për përmirësim”, sipas Rregullores Nr. 10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë Për Nëpunësit në Administratën e Sistemit Gjyqësor, është vlerësim që tregon se nëpunësja civile nuk ka arritur të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e saj. dhe se nga vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024, është konstatuar se është e nevojshme që e vlerësuara të përcjell trajnime shtesë sa i përket fushës së legjislacionit, përfshirë trajnimet sa i përket organizimit dhe funksionit të gjyqësorit–gjykatave koordinimit të punëve brenda administratës menaxhimin e administratës dhe personelit, financave publike raportimit si dhe sa i përket teknologjisë informative pasi që në shumë rast i mungojnë njohuritë bazë në zbatimin e plotë dhe të drejtë të legjislacionit me theks të veçantë sa i përket menaxhimit të administratës dhe mbikëqyrjes së funksioneve, mbanë takime me administratë pa caktuar rendin e ditës dhe pa përmbajtje të takimeve thjeshtë mungon planifikim në trajnime e çështjeve në takime, nuk ka dorëzuar raportet javore dhe mujore për përmbledhjen e punës së administratës ashtu siç është kërkuar nga vlerësuesi e po ashtu në rastet e dorëzimit të raporteve periodikë raportet kanë qenë të mangëta pa përmbajtura të qarta, në shumë raste gjatë vitit 2024, e vlerësuara ka hasur në vështirësi të madhe në zbatimin e drejte të akteve të miratuara nga KGJK-ja sa i përket menaxhimit të administratës me theks të veçantë ndarjes së punës të drejtave të punëtoreve të administratës në raport me pushimet, mbikëqyrjes së funksioneve administrative po ashtu edhe me detyrat e punë, siç janë të përcaktuara me përshkrimin e detyrave të punës.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtri, gjatë vitit 2024, nuk vërehet se ka kërkuar nga ankuesja ti kompletojë apo ndryshojë raportet e punës, ashtu siç ka konstatuar mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesen tek pjesa lidhur me objektivat.

Kolegji i Këshilli pas konstatim se ankuesja nga Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtri, sipas vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2024, është vlerësuar me notën e përgjithshme 2.12, dhe se ky vlerësim është i ulët. Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën e ankueses si të bazuar, në ligj, të anuloj Formuari për Vlerësimin e Rezultateve në punë për ankuesen Afërdita Tahiri, për vitin 2024, të datës 28.02.2025, të nxjerr nga Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtri, dhe çështjen të kthej në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, gjegjësisht të Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me detyrimin që Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore në Mitrovicë dega Vushtri të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen Afërdita Tahiri, sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, dhe pas konstatimit në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të nxjerr vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen Afërdita Tahiri, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshillë Juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr. 561/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses A.T;
- Gjyqtarit Mbikëqyrës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dega Vushtrri;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.